



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 14 mars, Salih Mustafa dorëzoi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë pas lëshimit të Aktgjykimit nga Paneli i Gjykatës së Apelit më 14 dhjetor 2023. Në Aktgjykim, Paneli i Apelit la në fuqi vendimin e fajësisë për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, por e uli dënimin e tij nga 26 vjet në 22 vjet burgim.

Mbrojtja e ligjshmërisë është një mjet juridik i jashtëzakonshëm, që duhet të ketë lidhje me një shkelje të pretenduar të Ligjit ose Rregullores. Në kërkesë, Mbrojtja e Mustafës pretendon shkelje të Ligjit për Dhomat e Specializuara, Rregullores së Procedurës dhe Provave, Kushtetutës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mbrojtja kërkon prapësim të pikave 1, 3 dhe 4 për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor, ose, në alternativë, anulim të Aktgjykimit, rigjykim, ose ulje të dënimit.

Më 15 mars, Paneli i Gjykatës Supreme i caktuar nga Kryetarja për shqyrtimin e kërkesës, urdhëroi Prokurorinë dhe Mbrojtësen e Viktimave të dorëzojnë përgjigjet që mund të kenë lidhur me kërkesën e Mbrojtjes për mbrojtje të ligjshmërisë, brenda 15 prillit 2024. Pas kësaj, Mbrojtja do të ketë mundësi të dorëzojë kundërpërgjigje brenda 21 ditësh.

Paneli i Gjykatës Supreme i caktuar për të vendosur në lidhje me kërkesën përbëhet nga gjykatësit Ekaterina Trendafilova, Kristinë van den Vajngart dhe Daniel Fransen.

Seancat në gjykimin e Hashim Thaçit dhe të bashkakuzuarve rinisën të hënën, më 18 mars, me dëshminë e dëshmitarit të dyzetënëntë të thirrur nga Prokuroria. Ky ishte dëshmitar i mbrojtur, dëshmia e të cilit, sipas përmbledhjes që u lexua në sallën e gjyqit, lidhej me një viktimë që ishte vrarë pasi ishte marrë dhe mbajtur i ndaluar nga anëtarët e UÇK-së në zonën e Llapit.

Dëshmitari i 50-të, z. Klod Kan (Claude Cahn), po ashtu dëshmoi të hënën. Dëshmia e tij lidhej me shkeljet e dokumentuara të të drejtave të romëve në Kosovë, gjatë punësimit të tij në Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve në korrik 1999. Dëshmitarit i bëri pyetje Prokuroria si dhe të katër ekipet e Mbrojtjes.

Të martën, dëshmoi dëshmitari i 51-të i thirrur nga Prokuroria. Ky ishte dëshmitar i mbrojtur, vëllai i të cilit, sipas Prokurorisë, u arrestua nga anëtarët e UÇK-së gjatë periudhës përkatëse dhe trupi i të cilit nuk është gjetur kurrë.

Dëshmitari i 52-të e filloi dëshminë përmes videolidhjes të martën dhe vijoi të mërkurën me pyetjet nga ekipet e mbrojtjes. Sipas Prokurorisë, ky dëshmitar i mbrojtur është shqiptar i Kosovës që u arrestua dhe mbajt i ndaluar nga anëtarët e UÇK-së në ose rreth gushtit 1998.

1





Më 14 mars, Administratorja njoftoi Trupin Gjykes për miratimin e znj. Nina Tavakoli si bashkëmbrojtëse e re për Hashim Thaçin dhe informoi gjykatësit lidhur me përfundimin e përfaqësimit nga një prej bashkëmbrojtësve të mëparshëm, me kërkesë të Mbrojtësit të z. Thaçi.

Bazuar në informacionin e dhënë nga Mbrojtja se këta dy bashkëmbrojtës do të shkëmbejnë rolet, Administratorja doli në përfundimin se Mbrojtja kishte demonstruar se ndryshimi nuk do të ketë pasoja negative mbi interesat e z. Thaçi apo në kohëzgjatjen e procesit gjyqësor.

Më 15 mars, Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në dy vendime të ndara. Për të dy të akuzuarit, gjykatësit konstatuan se ekziston ende rreziku që të pengojnë ecurinë e procesit gjyqësor dhe të kryejnë krime të tjera kundër atyre që konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, ku përfshihen dëshmitarë që kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në këtë çështje gjyqësore. Trupi Gjykes i qëndron mendimit se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm vetëm me anë të kornizës së monitorimit të komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të DHS-së.

Seancat në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* do të rifillojnë të hënën e ardhshme, më 25 mars në orën 09:00.

Më 19 mars, Trupi Gjykes në çështjen *Pjetër Shala* rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes për të rihapur çështjen dhe për pezullimin e afatit për dorëzimin e dosjeve gjyqësore përfundimtare dhe deklaratës së pasojave mbi viktimat. Mbrojtja pretendon se Prokuroria ka shkelur detyrimet për nxjerrjen e materialeve duke vënë në dispozicion tepër vonë disa materiale shfaqësuese që lidhen me një dëshmitar.

Në Vendim, Trupi Gjykes konstatoi se, ndonëse Prokuroria nuk kishte respektuar detyrimet për nxjerrjen e materialeve, dëshmia në fjalë nuk ishte e domosdoshme për përcaktimin e së vërtetës së dhe se Mbrojtjes nuk i ishte shkaktuar asnjë dëm. Duke gjykuar se mospërputhjet e ngritura nga Mbrojtja ishin të vogla, Trupi Gjykes konstatoi se rihapja e procedurës së paraqitjes së provave duke thirrur një dëshmitar të japë dëshmi ose të pranojë dëshminë e vet me shkrim, në këtë fazë përfundimtare të gjykimit, do të zgjaste në mënyrë të panevojshme procesin.

Më 18 mars, Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Shala pasi konstatoi se ka arsye të artikulueshme për të besuar se ekziston ende rreziku që z. Shala të pengojë ecurinë e procesit gjyqësor të DHSK-së dhe të kryejë krime të tjera.

Deklaratat përmbyllëse në gjykimin e Pjetër Shalës janë planifikuar të mbahen mes 15-19 prillit 2024.

Në çështjen Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala, konferenca e radhës për ecurinë e çështjes gjyqësore është planifikuar të mbahet nesër, më 22 mars në orën 14:30. Sipas urdhrit për caktimin e datës, ndër pikat që do të diskutohen përfshihet nxjerrja e materialeve dhe faza e hetimeve nga palët.





Më 19 mars, në të njëjtën çështje gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin lidhur me mocionin e Haxhi Shalës për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar. Gjykatësi i Procedurës Paraprake doli në përfundimin e Aktakuza e Konfirmuar evidenton me saktësi të mjaftueshme aspektet përkatëse të ngritura nga Mbrojtja dhe se paraqet me qartësi ose saktësi të mjaftueshme faktet mbi të cilat bazohet akuza e frikësimit gjatë procedurës penale e për rrjedhojë Gjykatësi e rrëzoi Mocionin.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

